

Vendim nr. 245 datë 30.09.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare
Genti Ibrahim, i,	Anëtar

në datën 30.09.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (Xh) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: XHEVE ÇULAJ

OBJEKTI: Shfuqizimi i paragrafit 5 të vendimit nr. 318, datë 25.06.2012 të Gjykatës së Apelit Shkodër, për sa i përket rrëzimit të kërkesëpadisë për pjesët e tjera, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-5055, datë 18.12.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 18, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 27 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Genti Ibrahim i, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër (*ZVRPP*), rezulton se në emër të kërku e sës është regjistruar titulli i pronësisë, për pasurinë e paluajtshme “truall plus ndërtesë”, nr. 6/295, ZK 8593, Shkodër. Kjo pronë rezulton se është fituar sipas aktit noterial të shitblerjes së datës 23.05.1992.

2. Po kështu, rezulton se pala e paditur në procesin e kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), ka në posedim një pasuri të paluajtshme, truall plus ndërtesë, që është në raporte fqinjësie, me pasurinë e kërku e sës.

3. Kërku e sja, duke pretenduar se pala e paditur posedon në mënyrë të paligjshme një pjesë nga pasuria e saj e paluajtshme, ka paraqitur kërkesëpadi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt detyrimin e të paditurit që t’i lirojë asaj pronën, për sa i përket oborrit, duke vendosur ndarjen në kufirin real midis dy pronave, si dhe kthimin e sipërfaqes së zënë në mënyrë të padrejtë nga ndërtimi pa leje i të paditurit [...].

4. Gjatë hetimit gjyqësor, ka paraqitur kërkesë për t’u legjitimuar si ndërhyrës kryesor në proces, shtetasja E.K.(S.), duke paraqitur kërkesëpadi, me objekt kthimin e sendit, me bazë ligjore nenin 296 të Kodit Civil, të cilën ia ka kundërdrejtuar si të paditurit, ashtu edhe kërku e sës. Kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër në kuptim të neneve 189 dhe 194 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*).

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 600, datë 08.03.2010, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesëpadisë dhe pranimin e pjesshëm të ndërhyrësit kryesor. Zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë absolute të aktit noterial të blerjes të lidhur në datën 23.05.1992, përpara noteres V.S., anëtare e Dhomës së Noterisë Shkodër, nga palët kontraktuese V.K. (shitëse) dhe kërku e sës (blerëse), si vijon: Fshirjen e regjistrimit të pronësisë të bërë në ZVRPP në emër të paditëses Xheve Çulaj për pasurinë e numërtuar me nr. 6/295 ZK 8593, Shkodër. Njohjen e bashkëpronësisë së ndërhyrësit kryesor E.S. me Thesarin e Shtetit për pasurinë e paluajtshme nr. 6/295 ZK 8593, Shkodër, duke u përcaktuar raportet e pronësisë ndërmjet këtyre subjekteve sipas dëshmisë së trashëgimisë të së ndjerës V.K. dhe sipas të dhënave të radhorit të pronësisë nr. 27,

datë 23.03.1976 të ish-Zyrës së Hipotekës Shkodër [...]”. Ndaj këtij vendimi kanë bërë ankim kërkuesja dhe ndërhyrësi kryesor.

6. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 318, datë 25.06.2012, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 600, datë 08.03.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në këtë mënyrë: Rrëzimin e kërkesëpadisë së ndërhyrësit kryesor E.S., si të pambështetur në ligj e në prova. Pranimin pjesërisht të padisë së paditëses Xheve Çulaj. Detyrimin e të paditurit t’i kthejë kërkueses truallin me sipërfaqe 3.7 m² sipas planvendosjes së pronës së pasqyruar në hartën që i bashkëngjitet vendimit nr. 2975, datë 29.12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesët e tjera të saj.”.

7. Për rekursin e palës së paditur në proces dhe ndërhyrësit kryesor, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 156, datë 28.01.2016, ka vendosur mospranimin e tyre. Në vijim, rezulton se kërkuesja i është drejtuar gjykatës së apelit me kërkesë për rivendosjen në afat për të paraqitur rekurs ndaj vendimit të asaj gjykate, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata e apelit.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-5055, datë 18.12.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së.

9. Në datën 09.06.2025 (*sipas shënimit të shërbimit postar*), kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 25.06.2025.

II

Pretendimet e kërkueses

10. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

10.1. Parimi i barazisë përpara ligjit dhe ai i sigurisë juridike, si dhe e drejta e pronës, pasi ndaj saj nuk është zhvilluar një proces i drejtë, duke mos u respektuar e drejta për gjykim të drejtë, të paanshëm dhe brenda një afati të caktuar. Sipas kërkueses, janë shkelur nenet 15, 18, 41 dhe 42 të Kushtetutës. Për nenin 15 të Kushtetutës, kërkuesja ka argumentuar se është detyrë e organeve publike të respektojnë dhe të realizojnë përmbushjen e të drejtave themelore të njeriut, siç është ajo për siguri juridike dhe për të gëzuar e poseduar qetësisht pronën. Në lidhje me nenin 18 të Kushtetutës, sipas kërkueses është krijuar diskriminim dhe pabarazi me ata që gëzojnë e posedojnë pronat e tyre. Ndërsa për nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës, kërkuesja ka argumentuar se kushdo ka të drejtën që të gëzojë dhe të posedojë

qetësisht pronën e tij dhe se është cenuar e drejta për një proces të drejtë ligjor, brenda një afati të arsyeshëm.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

11. Çështja e legjitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative. Në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Kolegji evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuetin. Në këtë drejtim, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

13. Në kuptim të sa më sipër, në vlerësimin paraprak të respektimit të kriterëve të legjitimit për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, në drejtim të pretendimeve të parashtruara nga kërkuetja, në mbështetje të ankimit kushtetues individual, Kolegji fillimisht do të vlerësojë kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*. Ky kriter legjitimimi përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për

mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive përpara se t’i drejtohet gjykatës; ii) ose kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.

14. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike nënkupton se kërkuesi, përpara se t’i drejtohet Gjykatës, duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës ka të bëjë me faktin se kontrolli i ushtruar nga Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes të të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll *subsidiar*, që do të thotë se individit duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Juridiksioni kushtetues për shkelje të të drejtave themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuesi të ketë shteruar mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor (*shih vendimin nr. 3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 15, datë 19.04.2013; nr. 32, datë 28.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Kolegji vëren se pretendimet dhe argumentet të cilat kërkuesja i ka parashtruar në ankimin kushtetues individual nuk i ka parashtruar përpara gjykatave të zakonshme. Kërkuesja nuk i ka parashtruar argumentet e saj të paraqitura në ankimin kushtetues individual as në ankimin e paraqitur në gjykatën e apelit, si dhe as në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se ajo nuk ka shteruar mjetet juridike efektive, përpara se t’i drejtohej Gjykatës, ndaj nuk legjitimohet për pretendimet e saj.

16. Për më tepër, referuar pretendimeve të parashtruara nga kërkuesja, Kolegji konstaton se edhe pse ajo ka cituar cenimin e disa të drejtave dhe parimeve kushtetuese, në thelb, nuk ka sjellë asnjë argument kushtetues dhe nuk ka arritur të provojë sesi këto vendime/qëndrime të gjykatës se apelit dhe të Gjykatës së Lartë, të cilat kundërshton, kanë cenuar këto parime dhe të drejta. Për rrjedhojë, Kolegji evidenton se kërkuesja edhe pse nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t’i drejtohej Gjykatës, nuk ka paraqitur as argumente kushtetuese në mbështetje të pretendimeve të saj. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ajo nuk legjitimohet në kërkesën e saj drejtuar Gjykatës.

17. Në këndvështrim të sa më lart, për shkak të karakterit kumulativ të tyre, nuk është i nevojshëm analizimi i mëtejshëm i plotësimit të kriterëve të tjera të legjitimitetit të ankimit kushtetues të individual të kërkuësës.

18. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuësës nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.